

Shefkije ISLAMAJ

ASPEKTI GJUHËSOR I GLOBALIZIMIT DHE SHQIPJA STANDARDE

Globalizimi dhe identiteti

Evropa e shekullit që kemi lënë dhe e fillimit të këtij shekulli karakterizohet me ndryshime të mëdha, me përparim tekniko-teknologjik, komunikim global dhe qarkullim të informacioneve. Në këtë kontekst duket i natyrshëm synimi i saj për bashkim të popujve të barabartë, të kulturave, të qytetërimeve e të traditave të tyre. Ajo synon të bëhet pluraliste, të ruajë pasuritë e saj në njësimin e përdallimeve, në të vërtetë të bëhet globale dhe shumëpamëshe. A është e lehtë të arrihet kjo? A duhet të kenë frikë popujt e vegjël të Evropës?

Evropa nga ana kulturore është shumë e larmishme, e përbërë dhe e gërshetuar nga shumë botë e kultura të vogla, lokale, regjionale e kombëtare, shumë nga të cilat nuk kanë asgjë ose pak të përbashkët. Për arsye të zhvillimit të përdalluar në hapësira të ndryshme të saj, për arsye edhe të historisë së ndryshme që kanë popujt e saj, bashkimi dhe njësimi politik i popujve evropianë ka paraqitur dhe paraqet shpesh utopi. A do të realizohen synimet e Evropës moderne do ta dëshmojë e ardhmja. Është pyetja tjetër që shtrohet shpesh sot.

Globalizimi, sot, kuptohet në mënyra të ndryshme. Shpesh kuptohet si globalizim i ideve dhe i realiteteve të botës pluraliste, shumëgjuhësore dhe shumëkulturore, si globalizim i bashkëpunimit dhe këmbimit të barabartë të ideve, vlerave kulturore dhe vlerave të tjera, si integrim në tregjet financiare, në tregjet e mallrave e shërbimeve, si lëvizshmëri e lartë e njerëzve dhe e kapitaleve, por shpesh kuptohet edhe si zgjerim i dhunshëm i sferës së ndikimit të grupit të vendeve më të fuqishme. **1**

Proceset e globalizimit sjellin edhe frikë te popujt më pak të fuqishëm ose më të varfër, sidomos kur mbiçmohen ndjenjat

mbikombëtare, kontinentalo-evropiane. Popujt e Evropës e dinë se ky bashkim me emrin globalizim, për arsye të shumë rrethanave të së shkuarës dhe të së tashmes, nuk do të thotë *dashuri*, po *nevojë* për tjetrin. Pra, globalizimi si proces planetar mund të shihet me të drejtë edhe si proces pozitiv që mund të ndihmojë edhe shtetet me zhvillim të mesëm ose të vogël ekonomik, duke i futur në ekonominë, tregun dhe në informatikën globale, por edhe si rrezik për *identitetin* dhe qenien e popujve të vegjël.

Globalizimi dhe gjuhët

Procesi intensiv i globalizimit ka shtruar shumë çështje për diskutim edhe në rrafshin gjuhësor. Duke qenë i lidhur ngushtë me zhvillimin tekniko-teknologjik, me zhvillimin informativ-komunikues, globalizimit i referohen edhe ndryshimet që po ndodhin në hartën gjuhësore të botës.

Tokat shqiptare nuk janë as të mëdha e as të zhvilluara, madje mund të thuhet se në hierarkinë e shumë përmasave zhvillimore në raport me botën e zhvilluar zënë pozita të papërfillshme. Zëri i shqiptarëve për dhe kundër globalizimit, edhe gjuhësor, është tepër i vogël ose mungon fare, ndërsa zgjidhja në të shumtën e rasteve kërkohet në variantet e ndryshme të luajalitetit dhe lidhjeve të varësisë me të fuqishmit. Në shtete të ndryshme çështja e globalizimit trajtohet si çështje e ditës, shumë aktuale, në të gjitha fushat e jetës njerëzore (informatikë, teknologji, ekonomi, gjeo-politikë, arsim, arte, semiotikë, etnologji, kulturologji e të tjera). Në këtë kontekst janë të pranishme si idetë globofilike, si ato globofobike, natyrisht të parat kanë më shumë përkrahës.

Në aspektin e gjuhëve, ana e mirë e globalizimit qëndron në përpjekjet zyrtare, të proklamuar, për ruajtjen dhe kultivimin e shumëgjuhësisë, ndërsa ana negative qëndron në faktin se këto parime të shumëgjuhësisë jo gjithmonë zbatohen në mënyrë parimore. Aty ku zgjerimi global i vlerave të përgjithshme njerëzore nuk rrezikon të arriturat e traditës lokale, aty ku globalja dhe lokalja mund të bashkëjetojnë, sigurisht se globalizimi nuk do

të kuptohet me tregues negativë, ndërkaq aty ku ekziston tendenca për “hegjemoni” globale **2** kjo, natyrshëm, do të nxisë rezistencë të arsyeshme të njerëzit e popujt me dinjitet kombëtar. Hegjemonizmi është vetëm një formë e mundshme e globalizimit. Zhvillimi i vetëdijes se ekzistojnë edhe aspekte të tjera të tij sjell vlerësime të dalluara për globalizimin, **3** vlerësimin skajshëm afirmativ ose skajshëm negativ: prej globalizimit vertikal deri te ai horizontal, prej globalizimit të dhunshëm deri te globalizimi vullnetar, prej globalizimit të përgjithshëm përmes globalizimit lokal, në të vërtetë regjional, deri te lokalizimi global, përkatësisht regjionalizimi global. Shpesh termat *bashkëpunim* dhe *kooperim* më shumë do të thonë dëgjueshmëri sesa që kanë përmbajtjen që ua njohim, kuptimin burimor.

Situata botërore gjuhësore dhe ndryshimet që shfaqen sot janë të kushtëzuara sidomos nga mbizotërimi i gjuhës globale – anglishtes. Globalizimi madje sot ka krijuar simbolin e vet dhe ky është gjuha angleze. Anglishtja është gjuha e komunikimit ndërkombëtar në të gjitha fushat kryesore të zhvillimit shoqëror, politik, ekonomik, teknik-teknologjik, informatik, kulturor, medial etj. Sa për ilustrim po përmendim se në rrjetin botëror të internetit mbizotëron gjuha angleze. Sipas rezultateve të projektit *Web Characterization* të OCLC-së **4** të realizuar në vitin 2002, deri 72% e përmbajtjeve tekstore në sajte janë në gjuhën angleze, 7% në gjuhën gjermane, 6% në gjuhën japoneze, 3% në spanjishte e 3% në frëngjishte dhe 9% në të gjitha gjuhët e tjera të globit. Edhe pse përdorues të internetit anglofolës janë 36.5%, sipas statistikave që nxjerr po ky projekt, anglishtja mbizotëron me 72% dhe më të drejtë mund të quhet gjuha e internetit.

Globalizimi paraqitet në forma të ndryshme edhe në shqipen. Forma e parë është përshtirja e anglishtes në përdorimin publik. Anglishtja në shumë vende të botës mësohet si gjuhë e parë e huaj, si gjuhë e vetme e huaj, si gjuhë e përdorimit publik, si gjuhë zyrtare, si gjuhë e dytë amtare ose si pasuese e një gjuhe të vdekur.

Në Kosovë anglishtja përdoret si gjuhë e dytë zyrtare. Ka përpjekje që, pos në Kosovë, edhe në disa vende fqinje ajo të bëhet

gjuhë e dytë zyrtare. Me anglishten në Kosovë nuk bëhet trysni vetëm në kurriz të gjuhës shqipes, por edhe në kurriz të gjuhëve të tjera të huaja, si frëngjishtes, gjermanishtes, italishtes etj.

Aspekt gjuhësor i globalizimit duhet të konsiderohet edhe kur një fjalë e një gjuhe botërore vendoset në leksikun e një gjuhe të vogël, duke i bërë të vdekura shumë fjalë burimore. Një dukuri e tillë është e përhapur shumë edhe në shqipen..

Në qoftë se globalizimi kulturor dhe gjuhësor realizohet si unifikim i shkallëshkallshëm, në të cilin gjuhët e vogla duhet të skajohen a mënjanoen në kurriz të zgjerimit të një gjuhe më të madhe, atëherë atje ku ka ndjenja e dinjitet duhet të shfaqet rezistencë ndaj një globalizimit të tillë, në të kundërtën do të krijohet e zhvillohet ndjenja e inferioritetit, ndërkaq mbijetesa e më të dobëtit do të varet nga forca dhe qëndrueshmëria e tij.

Si qëndron puna në hapësirën tonë gjuhësore e kulturore? Mund të thuhet se ndjenjat e vetëmbrojtjes dhe inferioriteti ende janë larg hapësirës shqiptare gjuhësore. Globalizimi ende nuk është kuptuar dhe nuk kuptohet seriozisht.

Globalizimi dhe identiteti kombëtar

Siç mund të kuptohet, globalizimi paraqet përpjekje të ndërtimit të diçkaje të re në gjithë botën. Por, dihet se kur diçka ndërtohet, kjo duhet të ndodhë në hapësirë të lirë, ose duhet të rrënohet diçka ekzistuese për t'i bërë vend së resë. Në tokë nuk ka shumë hapësirë të lirë. Për këtë arsye globalizimi duhet të kuptohet edhe si proces rrënues. Format e këtij procesi janë edhe copëzimi, lëkundja, prishja, imtësimi, çrrënjimi e rrafshimi. Por të kujt? Të shteteve, të ekonomive, të kulturave, prandaj edhe të gjuhëve. Prirje rrënuese e copëzuese vërehen edhe në hapësirën shqiptare, kulturore e gjuhësore, sidomos gjuhësore. Edhe vetë çështja e identitetit kombëtar paraqitet çdo ditë më shumë si primitivizëm për popujt e vegjël, kurse për popujt e mëdhenj e të fuqishëm si prestigj. Në Kosovë, si rrjedhojë dhe në emër të këtij ndërtimi, copëzimi a rrënimi, mund të shihet edhe ngatërimi i *identitetit*

kombëtar me identitetin shtetëror, në të vërtetë përpjekja për rrënimin a ndryshimin e identitetit kombëtar për një pjesë të kombit dhe përpjekja për pranimin e një identiteti të ri, të paqenë dhe, rrjedhimisht, edhe të një gjuhe të veçantë për një pjesë të kombit - për shqiptarët e Kosovës!

Globalizimi dhe shqipja

Situata jonë gjuhësore flet se në mjedisin tonë globalizimi kuptohet në mënyrë të gabuar, në të vërtetë po keqkuptohet dhe si pasojë e kësaj po zhvillohen një varg procesesh rrënuese për gjuhën shqipe, për kulturën shqiptare dhe, madje, për identitetin shqiptar. Këto procese janë:

-statusi i shqipes në hapësirën shqiptare, brenda dhe, sidomos, jashtë kufijve, ashtu si edhe statusi i shqipes në vendet e huaja, ku numri i shqiptarëve me status emigranti ekonomik, politik etj. është shumë i madh, ndërsa shqipja si gjuhë amtare paraqitet e rrezikuar për arsyet e njohura;

-përpjekja për copëzimin e hapësirës gjuhësore dhe përpjekja për krijimin e gjuhëve të reja politike. Në këtë aspekt për shqipen dalin dy rreziqe: nga globalizimi dhe nga krahinorizmi, që të dyja vetëdije të dëmshme për shqipen standarde;

-mungesa e ligjit për gjuhën. Përpjekjet që të krijohen mekanizma të efektshëm që do të rregullonin përdorimin publik të shqipes standarde në gjithë hapësirën shqiptare mbeten vetëm projekt i dashamirësve të gjuhës;

-zotërimi i mangët i normës gjuhësore: lëkundjet më të mëdha ose më të vogla normative, në të vërtetë inferioriteti çdo ditë e më i madh i folësve të shqipes ndaj normës gjuhësore të saj. Jemi dëshmitarë se po zhvillohen procese degraduese në të gjitha rrafshet e normës gjuhësore të shqipes standarde;

-rrënimi i kulturës gjuhësore, posaçërisht i kulturës së shprehjes me shkrim e me gojë;

-depërtimi i shpejtë pothuajse stihik i fjalëve të huaja, sidomos i anglicizmave në shqipen. Përdorimi i madh

përgjithësisht i fjalëve dhe i elementeve të huaja, sikur po lëkund a dobëson strukturat gramatikore të shqipes; problemet në rrafshin e terminologjisë duken të pakapërcyeshme në këtë shkallë të zhvillimit të gjuhës dhe në këtë shkallë të përpjekjeve institucionale e individuale për ta trajtuar problemin seriozisht e me ndjeshmëri; hartimi i fjalorëve terminologjikë është shumë i paktë, ndonëse ky problem nuk zgjidhet vetëm me hartimin e fjalorëve dhe krijimin e komisioneve; problemet në këtë fushë i ka shtuar e ndërlikuar interneti me “super invazionin” e termave të tij;

-varfërimi i larmisë dialektore për arsye të tërheqjes së shumë të folmeve. Shpesh harrohet se dialektet, si bërthama themelore gjuhësore, mbeten mbështetja dhe burim i rëndësishëm për pasurimin e shqipes standarde;

-imponimi i gjuhës së mediave dhe i gjuhës bisedore si stile kryesore funksionale. Në mediat, sidomos në ato elektronike, ka rënë ndjeshëm prestigji i shqipes standarde, si rrjedhojë jo vetëm e disiplinës së vogël gjuhësore, padijes e papërgjegjësisë së folësve, përkthyesve, redaktorëve dhe realizuesve të emisioneve, po edhe për arsye të rënies së ndjeshmërisë dhe nderimit për kategoritë elementare të qenësisë sonë kombëtare;

-vulgarizimi i gjuhës së mediave, teatrove, filmit, letërsisë si edhe i gjuhës së përditshme, të cilat çdo ditë e më shumë po zhargonizohen dhe po i ngjajnë gjuhës së rrugës; përpjekja që kjo gjuhë të bëhet normë e (jo)kulturës ligjërimore;

-depërtimi i gjuhëve dhe i shkrimeve jo shqipe në sferën e përdorimit publik të gjuhës në gjithë hapësirën shqiptare - në firma, reklama, media e të ngjashme, dhe shmangia ose skajimi i shqipes nga kjo sferë e përdorimit. Anglishtja ka fituar një status epërsie edhe në këtë fushë të përdorimit publik të shqipes standarde dhe nga ky aspekt mund të thuhet se globalizimi ka bërë punën e vet – ka njëjtësuar botën më lehtë se në çdo fushë tjetër; mbishkrimet e reklamave e njëjta i gjen në krejt qytetet e botës;

-ndryshimet në politikën e mësimin të gjuhëve të huaja, favorizimi i anglishtes në dëm të gjuhëve të tjera të huaja - frëngjishtes, gjermanishtes, italishtes e të tjera.; edhe vetë politika

e mësimit të gjuhëve të huaja zhvillohet në këtë drejtim: çdo ditë e më shumë fëmijët tanë shkollohen në gjuhë të huaja, në rend të parë në anglishten.

-favorizimi në sferën e punësimit të atyre me njohje të gjuhëve të huaja, po jo edhe të shqipes (shpesh në konkurset për punësim kushti kryesor që kërkohet të plotësohet është njohja e anglishtes, ndërsa për shqipen nuk kërkohet plotësimi i asnjë lloji kushti, edhe në vendet e punës ku “punohet”, në rend të parë, me gjuhën shqipe, ndërsa dihet se cila është përgatitja gjuhësore e brezit tonë të ri;

-ndryshimi i statusit të gjuhësisë dhe albanologjisë në përgjithësi; rënia e interesimit për hulumtimet gjuhësore albanologjike jo vetëm në vend por edhe jashtë, në qendrat e njohura për studime të këtuja deri vonë; mungesa e mbështetjes së duhur, sidomos financiare, shtetërore në gjithë hapësirën shqiptare për hulumtime në këtë fushë, që për pasojë ka sjellë pakësimin e kuadrit dhe rënien e cilësisë së arsimimit: trajtimi dhe mënyra e funksionimit të instituteve shkencore, zvogëlimi i kuadrit, zvogëlimi i numrit të studentëve shqiptarë dhe të huaj, pakësimi i vëllimit të botimeve albanologjike dhe rënia e madhe e cilësisë së këtyre botimeve, mungesa e ekspeditave shkencore hulumtuese në terren, natyrisht jo me mënyrën dhe vëllimin e njëjtë në të gjithë hapësirë shqiptare etj. Institutet shkencore me vite nuk përtërijnë kuadrin, ndërsa edhe specializimet brenda e jashtë hapësirës shqiptare janë reduktuar shumë. Në Katedrat Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Letërsi dhe Gjuhë Shqipe gjendja e kuadrove nuk na paraqitet më e rëndë as në fillimet e punës së tyre para, pothuajse, dyzet vjetëve – një mësimsdhënës ligjëron tri e katër lëndë dhe në tri e katër fakultete, ndërsa të shpeshta janë rastet kur mësimsdhënësit nuk janë specialistë të lëndëve përkatëse dhe nuk kanë dhënë asnjë kontribut nga fusha përkatëse shkencore e profesionale, në të vërtetë shumë nga lëndët mbulohen sa për të thënë - një gjendje kjo që do të mund të kuptohej në vitet '60 të shekullit të kaluar, po jo në asnjë mënyrë sot, ndonëse edhe asokohe nuk na paraqitet gjendja e tillë, sepse në mungesë të

mësimdhënësve të lëndës ftoheshin kuadrot prej universiteteve të tjera. Del natyrshëm kërkesa që albanologjia të trajtohet si duhet në fakultete e në institute, del natyrshëm kërkesa që albanologjia të mos mbetet vetëm shkencë kabinetike dhe akademike, ajo duhet të marrë karakter pragmatik, sepse e kërkon koha.

A kanë të gjitha këto lidhje me globalizimin? Nëse e pranojmë përgjigjen pozitive, natyrshëm, shtrohet pyetja - çka të bëjmë?

Sigurisht që nuk duhet t'i shpallet luftë globalizimit, por duhet të përpiqemi për një globalizim në kuptim të mirë të fjalës, për globalizimin që nxit ndjenjat për respekt vetjak e kombëtar, për vetërespekt, për globalizim që do të na bashkojë me të tjerët me vlerat e ndërsjella, për globalizim në të cilin edhe shqipja dhe kultura shqiptare do të zhvillohen e do të kultivohen krahas vlerave në shtrirje të gjerë planetare. Do të duhej të shihnim edhe përtej vetes – çka bëjnë kombet e shtetet në kushtet e globalizimit? Si i pranojnë proceset pozitive e si u bëjnë ballë proceseve negative që i nxit globalizimi, si i ruajnë e si i përforcojnë vlerat e tyre, në të vërtetë si e ruajnë *identitetin* e tyre, sepse mënyra më e mirë për ta paraparë ardhmërinë tonë është ta krijojmë atë. Ta bëjmë shqipen mjet integrimi midis nesh dhe mjet integrimi me të tjerët. Shkurt e thënë: të gjejmë rrugët që pajtojnë atdhetarizmin dhe globalizmin!

Fusnotat

1. Globalizimi ka krijuar tashmë edhe fjalorin e vet të koncepteve, ideve e nocioneve (të kujtojmë disa nga ato: *ekonomi globale, tregti globale, elitë globale, gjuhë globale, teknologji informatike globale, integrime globale, internet global, korporatë globale, kozmopolitizëm, hegjemoni, bashkësi ndërkombëtare, union evropian, bankë botërore, fond ndërkombëtar botëror, lëvizje paqësore, korporatë multinacionale, multipolaritet, marketing botëror, fshati global, Rruga e tretë, Roma e tretë* etj.)

2. Shih për këtë çështje librin shumë të përfolur të Noam Çomskit të përkthyer në kroatishten nga Damir Biličić: *Hegemonia*

ili opstanak: američke težnje za globalnom dominacijom (Hegjemonia apo mbijetesa, aspiratat amerikane për dominim global), “Naklada Ljevak” Zagreb 2004 dhe librin e autorit Jeremy Fox, Chomsky i globalizacija, Zagreb 2001.

3. Shih librin *Globalizacija ili nova imperija Pax Americana* të Vojislav Miqoviqit, Beograd 2005, në të cilin trajtohen aspekte të ndryshme të globalizimit.

4. Organizata *Online Computer Library Center*, (OCLC), shih në internet në adresën: <http://www.oclc.org>.

Literatura

1. Dukovski, Darko, *Globalizacija: i strah i nada malih evropskih naroda*, në internet në këtë adresë www.eurozine.com/article/2005-08-03-dukovski-hr.html.

2. Gidens, Entoni (Anthony Giddens), *Posledice modernosti*, Beograd 1998;

3. Grup autorësh, *Aspekti globalizacije*, Beograd 2003.

4. Hobsbaum, Erik, *Doba ekstrema*, Beograd 2001.

5. Hungtinton, P. Samuel, *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror*, Logos –A, Shkup 2004.

6. Radovanoviq, Milorad, *Spisi iz kontekstualne lingvistike*, Novi Sad 1997.

7. Kalanj, Rade, *Globalizacija i postmodernost*, Zagreb 2004.

8. Vendryes, Joseph, *Govor*, Novi Sad 1998.

*Sesioni shkencor në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën. Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2008, Prishtinë